1. Kur autoriteti kompetent përcakton se ushqimi për kafshë paraqet rrezik serioz për shëndetin e njeriut, shëndetin e kafshëve ose mjedisin dhe që rreziku i tillë nuk mund të menjanohet në mënyrë të përshtatshme, Autoriteti Kompetent, varësisht nga shkalla e rrezikut nderrmer masat si në vijm:	1. When it is determined by the Competent authority that feed is likely to constitute a serious risk to human health, animal health or the environment, and that such risk cannot be contained satisfactorily, Competent Authority shall immediately adopt one or more of the following measures, depending on the gravity of the situation:	1. Kada nadležni organ utvrdi da hrana za životinje predstavlja ozbiljnu opasnost po zdravlje ljudi, zdravlje životinja i okolinu, i da se takva opasnost ne može otkloniti na odgovarajući način, nadležni organ odmah usvaja jednu ili više od sledećih mera, u zavisnosti od stepena opasnosti:
1.1. në rastin e ushqimit për kafshë me origjinë vendore:	1.1.in the case of feed of national origin:	1.1.u slučaju hrane za životinje domaćeg porekla:
1.1.1. pezullimin e plasimit në treg ose përdorimin e ushqimit;	1.1.1. suspension of the placing on the market or use of the feed in question;	1.1.1. privremena zabrana stavljanja hrane za životinje na tržište ili upotrebe te hrane za životinje;

1.1.2. përcakton kushte të veçanta për ushqimin e kafshëve;	1.1.2. laying down special conditions for the feed in question;	1.1.2. utvrđivanje posebnih uslova za pomenutu hranu za životinje;
1.1.3. çdo masë tjetër të përkohshme dhe të përshtatshme;	1.1.3. any other appropriate interim measure;	1.1.3. ostale odgovarajuće privremene mere;
1.2. në rastin e importit të ushqimit të kafshëve:	1.2. in the case of imported feed:	1.2 u slučaju uvezene hrane za životinje:
1.2.1. pezullimi i importeve të ushqimit për kafshë nga vendi apo pjesa e tij dhe, kur është e nevojshme edhe nga vendet e tranzitit;	1.2.1 suspension of imports of the feed in question from all or part of the country concerned and, where applicable, from the country of transit;	1.2.1. privremena zabrana uvoza hrane za životinje iz cele ili dela dotične države i ako je potrebno, iz države tranzita;
1.2.2. përcaktimi i kushteve të veçanta për ushqimin për kafshë, nga të gjitha pjeset e vendit, dhe	1.2.2 laying down special conditions for the feed in question from all or part of the country concerned; and	1.2.2. utvrđivanje posebnih uslova za navedenu hranu za životinje iz cele ili dela zemlje izvoznice; i
1.2.3. çdo masë tjetër e përkohshme dhe e përshtatshme.	1.2.3 any other appropriate interim measure.	1.2.3. ostale odgovarajuće privremene mere.
2. Kur serioziteti i rrezikut i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni është konfirmuar me analizën e riskut, autoriteti kompetent urdhëron masa të përhershme për ndalimin e vendosjes në treg të ushqimit	2. When severity of the risk referred to in paragraph 1 of this Article is confirmed by risk analysis, the competent authority shall order a permanent measure prohibiting the placing on the market of feed in question.	2. Kada je ozbiljnost rizika iz stava 1. ovog člana potvrđena analizom rizika, nadležni organ naređuje trajnu meru kojom se zabranjuje stavljanje u promet dotične hrane za životinje.
<b>Neni 27</b> <b>Dispozitat përfundimtare</b>	<b>Article 27</b> <b>Final provisions</b>	<b>Član 27</b> <b>Završne odredbe</b>
1. Pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi	1. All feed business operators applying for	1. Svi subjekti u poslovanju Hranom za

administrativ të gjithë operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë të cilët aplikojnë për regjistrim apo aprovim duhet ti përmbushin kërkeat e përcaktuara të këtij udhëzimi administrativ	the registration or approval of new establishments after the entry into force of this administrative instruction must comply with the requirements laid down in this administrative instruction.	zivotinje koji podnesu zahtev za registraciju ili odobrenje novih objekata nakon stupanja na snagu ovog administrativnog uputstva moraju da budu u skladu sa zahtevima utvrđenim ovim administrativnom uputstvom.
<p>2. Operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë mund të vazhdojnë të kryejnë aktivitetet deri në (6) gjashtë muaj nga dita e hyrjes në fuqi e këtij udhëzimi administrativ, me kusht që të parashtrojnë aplikacionin për regjistrim apo aprovim në pajtim me dispozitat e këtij udhëzimi administrativ.</p> <p>3. Për objektet për të cilat operatorët e biznesit kërkojnë regjistrim së bashku me aplikacionin për regjistrim, janë të obliguar të parashtrojnë edhe deklaratën e përputhshmërisë sipas nenit 12 paragrafit 1 të këtij udhëzimi administrative.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 28</b></p> <p>Pjesë përbërëse të këtij udhëzimi administrativ janë Shtojcat I deri V.</p>	<p>2. All feed businesses that operates may continue to perform the activities up to (6) six months from the date of entry into force of this administrative instruction and may submit an application for registration or approval in accordance with the provisions to this administrative instruction.</p> <p>3. For establishments that require registration according to Article 12 paragraph 1 to this administrative instruction, feed businesses are obliged to submit Statement of compliance with the requirements of this administrative instruction together with an application for registration.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 28</b></p> <p>Annexes I to V to this administrative instruction are an integral part thereof.</p>	<p>2. Svisubjekti hranom za zivotinje koji posluju mogu nastaviti da sprovode aktivnosti do (6) sest meseci nakon stupanja na znazi ovog administrativnog uputstva pad uslovom da podnesu zahtev za registraciju ili odobrenje u skladu sa odredbama ovog administrativnog uputstva.</p> <p>3. Za objekte koji zahtevaju registraciju u skladu sa članom 12. stav 1. Ovog administrativnog uputstva, od subjekata u poslovanju hranom za zivotinje se zahteva da podnesu izjavu o uskladenosti sa zahtevima ove Uredbe zajedno sa prijavom za registraciju.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član28</b></p> <p>Aneksi I do V čine sastavni dio ovog administrativnog uputstva.</p>
<p><b>Neni 29</b> <b>Hyrja në fuqi</b></p>	<p><b>Article 29</b> <b>Entry into force</b></p>	<p><b>Član 29</b> <b>Stupanje na snagu</b></p>

<p>Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ana e Ministrit.</p> <p>  Nenad Rikalo</p> <p>Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural</p> <p>27/01/2019</p>	<p>This administrative instruction shall enter into force seven (7) days after the signature of minister.</p> <p>  Nenad Rikalo</p> <p>Minister of the Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development</p> <p>27/01/2019</p>	<p>Ovo administrativno uputstvo stupa na snagu sedam (7) dana nakon potpisivanja od ministra.</p> <p>  Nenad Rikalo</p> <p>Ministar Ministarstva Poljoprivrede Sumarstva i ruralnog Razvoja</p> <p>27/01/2019</p>
---	---	---

**SHTOJCA I**  
**PRODHIMI PRIMAR**  
**PJESA A**

**Kërkesat për bizneset me ushqimin për kafshë në nivelin e prodhimit primar të ushqimit për kafshë të përmendur në nenin 5**  
**(1)**

**I. Dispozitat e higjienës**

1. Operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë që kryejnë prodhimin primar të ushqimit për kafshë duhet të sigurojnë që operacionet të menaxhohen dhe të kryhen në mënyrë të tillë që të parandalojnë, eliminojnë ose minimizojnë hazardin që mund të rrezikojnë sigurinë e ushqimit për kafshë.
2. Operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë duhet të sigurojnë, aq sa është e mundur, që produktet primare të prodhuara, përgatitura, pastruara, paketuara, ruajtura dhe transportuara nën përgjegjësinë e tyre të jenë të mbrojtur nga kontaminimi dhe prishja.
3. Operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë duhet të përmbushin detyrimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 duke respektuar dispozitat përkatëse legjislative kombëtare që kanë të bëjnë me kontrollin e hazardeve, duke përfshirë:
  - 3.1. masat për kontrollimin e hazardit të kontaminimit siç janë ato që dalin nga ajri, toka, uji, fertilizuesve, produkteve mbrojtjes të bimëve, biocidet, produktet medicinale veterinarë dhe trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave, dhe
  - 3.2. masat që lidhen me shëndetin e bimëve, shëndetin e kafshëve dhe mjedisin që kanë implikime për sigurinë e ushqimit të kafshëve, përfshirë programet për monitorimin dhe kontrollin e zoonozave dhe agjentëve zoonotikë.
4. Në rastet kur është e përshtatshme, operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë duhet të marrin masat adekuate, në veçanti:
  - 4.1. për të mbajtur të pastër dhe, kur është e nevojshme pas pastrimit, të dezinfektojnë në mënyrë të përshtatshme objektet, pajisjet, kontejnerët, arkat dhe mjetet e transportit të përdorura për prodhimin, përgatitjen, klasifikimin, paketimin, ruajtjen dhe transportimin e ushqimit për kafshë;
  - 4.2. për të siguruar, aty ku është e nevojshme, higjiena e prodhimit, kushtet e transportit dhe ruajtjes, si dhe pastërtinë e ushqimit për kafshë;
  - 4.3. për të përdorur ujë të pastër kurdo që është e nevojshme për të parandaluar kontaminimet nga hazardet;

4.4. për të parandaluar kontaminimin nga hazardet që vijnë nga kafshët dhe demtuesit e tjerë;

4.5. për të ruajtur dhe trajtuar mbeturinat dhe substancat e rrezikshme, veç e veç në mënyrë të sigurt, që të parandalohet kontaminimi i ushqimit nga hazardet;

4.6. për të siguruar se materialet e paketimit nuk janë burim i kontaminimit të ushqimit nga hazardet;

4.7. për të marrë në konsideratë rezultatet e çdo analize relevante të kryer në mostrat e marra nga produktet primare ose mostrat tjera relevante për sigurinë e ushqimit për kafshë.

## **II. Mbajtja e regjistrave**

1. Operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë duhet të mbajnë shënime në lidhje me masat e vendosura për të kontrolluar hazardet, në mënyrë të përshtatshme dhe për një periudhë kohore, në proporcion me natyrën dhe madhësinë e biznesit me ushqimin për kafshë. Operatorët e biznesit me ushqimin për kafshë duhet të jenë në dispozicion të gjitha shenimeve relevante autoritetit kompetent.

2. Operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë duhet, në veçanti, të mbajnë shënime për:

1.1. çdo përdorim të produkteve për mbrojtje bimore dhe biocideve;

1.2. përdorimin e farave gjenetike të modifikuara;

1.3. çdo dukuri të demtuesve ose sëmundjeve që mund të ndikojnë në sigurinë e produkteve primare;

1.4. rezultatet e analizave të kryera në mostrat e marra nga produktet primare ose nga mostrat tjera të marra për qëllime diagnostikuese që kanë rëndësi për sigurinë e ushqimit për kafshë;

1.5. burimi dhe sasia e çdo hyrjeje të ushqimit dhe destinacioni dhe sasia për çdo dalje të ushqimit.

3. Personat e tjerë, si veterinerët, agronomët dhe teknikët e fermës, mund të ndihmojnë operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë me mbajtjen e regjistrave relevante për aktivitetet që ata kryejnë në fermë.

## **PJESA B**

### **Rekomandime për udhëzuesit për praktikë të mire**

1. Kur hartohen udhëzimet kombëtare të referuara në Nenet 20-21 të kësaj Rregulloreje, ato duhet të përmbajnë udhëzime mbi praktikën emira për kontrollin e hazardeve në prodhimin primar të ushqimit për kafshë.
2. Udhëzuesit për praktika të mira përfshijnë informacionin e duhur për hazardet që paraqiten në prodhimin primar të ushqimit për kafshë dhe veprimet për të kontrolluar hazardet, duke përfshirë masat relevante të përcaktuara në legjislacionin kombëtar ose në programet kombëtare, siç janë:
  - 2.1 Kontrolli i kontaminimit si mykotoksinat, metalet e rënda, materiale radioaktive;
  - 2.2 përdorimi i ujit, mbetjeve organike dhe fertilizuesve;
  - 2.3 përdorimi korrekt dhe i saktë i produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe biocideve si dhe gjurmueshmërinë e tyre;
  - 2.4 përdorimi korrekt dhe i saktë të produkteve medicinale veterinarë dhe aditivëve të ushqimit për kafshë dhe gjurmueshmërinë e tyre;
  - 2.5 përgatitja, ruajtja dhe gjurmueshmëria e materialeve për ushqim për kafshë;
  - 2.6 asgjësimi i duhur i karkasave të kafshëve të ngordhura dhe mbeturinave;
  - 2.7 masat mbrojtëse për të parandaluar dukurinë e sëmundjeve ngjitëse të transmetueshme tek kafshët përmes ushqimit për kafshë dhe çdo obligim për të njoftuar autoritetin kompetent;
  - 2.8 procedurat, praktikën dhe metodat për të siguruar që ushqimi është prodhuar, përgatitur, paketuar, ruajtur dhe transportuar në kushte adekuate higjienike, duke përfshirë pastrimin efektiv dhe kontrollin e dëmtuesve;
  - 2.9 detajet të ndërlidhura me mbajtjen e regjistrave.

## SHTOJCA II

Kërkesat për bizneset e ushqimit për kafshë, përveç atyre në nivelin e prodhimit primar të ushqimit për kafshë të përmendur në nenin 5 (1)

### I. PËRKUFIZIMET

#### II.

Për qëllimet e këtij Shtojca, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. “numri serik” nënkupton një sasi të identifikueshme të ushqimit të përcaktuar që ka karakteristika të përbashkëta, të tilla si origjina, varietet, lloji i paketimit, paketuesi, dërguesi ose etiketimi, dhe, në rastin e një procesi prodhimi, një njësi prodhimi nga një stabiliment i vetëm duke përdorur parametra të njëtrajtshëm të prodhimit ose një numër njësisish të tilla, kur prodhohen në mënyrë të vazhdueshme dhe ruhen së bashku;
2. “produktet e nxjerra nga vajrat dhe yndyrat” nënkupton çdo produkt që rrjedh direkt ose indirekt nga vajrat dhe yndyrat e papërpunuara ose të rikuperuara nga përpunimi ose distilimi oleokimik ose bionaftës, rafinimi kimik ose fizik, përveç:

2.1 vajit të rafinuar,

2.2 produkteve e ncjerrura nga vaji i rafinuar, dhe

2.3 aditivët e ushqimit për kafshë;

3. “përzierja e yndyrës” nënkupton prodhimin e ushqimit për kafshë të përbërë ose, në rast të gjithë komponentëve që i përkasin të njëjtës hyrje siç përcaktohet nga legjislacioni specifik në katalogun e materialeve ushqyese që ncjerren nga të njëjtat bime ose specie shtazore, materiale të ushqimit për kafshë duke përzier vajrat e papërpunuara, vajrat e rafinuara, yndyrnat ekafshëve, vajrat e nxjerra nga operatorët e biznesit të ushqimit që përfshihen në fushën e veprimit të Regullorës 11/2011 për higjienën e prodhimeve ushqimore produktet e nxjerra prej tyre për të prodhuar një vaj ose yndyrë të përzier, me përjashtim të:

3.1 ruajtja vetëm e grumbullit të njëpasnjëshëm, dhe

3.2 përzierja ekskluzive e vajrave të rafinuar;

4. “vaj ose yndyra e rafinuara” nënkupton vaj ose yndyrë që është nënshtruar procesit të rafinimit siç përcaktohet nga legjislacioni specifik në katalogun e materialeve ushqyese.

## II. OBJEKTET DHE PAISJET

1. Objektete përpunimit dhe ruajtjes së ushqimit për kafshë, paisjet, kontejnerët, kafazet, mjetet e transportit dhe hapsirat përreth tyre duhet të mbahen të pastra dhe të zbatohen programe efektive të kontrollit të dëmtuesve.
2. Vendorsja, dizanjimi, ndërtimi dhe madhësia e objekteve dhe pajisjeve do të:
  - 2.1 lejojnë pastrimin dhe/ose dezinfektimin adekuat;
  - 2.2 të jenë të tilla që të minimizojnë rrezikun e gabimeve dhe të shmangin kontaminimin, kontaminimin e kryqëzuar dhe çdo efekt negativ në përgjithësi në sigurinë dhe cilësinë e produkteve. Makineritë që vijnë në kontakt me ushqimin duhet të thahen pas çdo procesi të pastrimit.
3. Hapsirat dhe pajisjet që do të përdoren për operacionet e përzierjes dhe/ose prodhimit duhet t'i nënshtrohen kontrolleve të përshtatshme dhe të rregullta, në përputhje me procedurat e shkruara të paracaktuara nga prodhuesi për produktet.
  - 3.1 Të gjitha peshoret dhe pajisjet matëse të përdorura në prodhimin e ushqimeve për kafshë duhet të jenë të përshtatshme për gamën e peshave ose volumeve që duhet të maten dhe duhet të testohen për saktësi rregullisht.
  - 3.2 Të gjithë mikserat të përdorura në prodhimin e ushqimeve për kafshë duhet të jenë të përshtatshme për gamën e peshave ose volumeve që do të përzihen dhe duhet të jenë në gjendje të prodhojnë përzierje dhe tretësira homogjenetë përshtatshme. Operatorët duhet të demonstrojnë efektivitetin e mikserit sa i përket homogjenitetit.
4. Objektet duhet të kenë ndriçim adekuat natyror dhe / ose artificial.
5. Objektet e kullimit duhet të jenë të përshtatshme për qëllimin e synuar; ato duhet të projektohen dhe ndërtohen për të shmangur rrezikun e ndotjes së ushqimeve për kafshë.
6. Uji i përdorur në prodhimin e ushqimit për kafshë duhet të mos jetë me cilësi të përshtatshme për kafshët; gypat për ujë duhet të jenë të lira nga materialet inerte.
7. Ujrat e hedhura hedhurinat dhe ujrat e shijut duhet të rrjedhin në atë mënyrë që të mos ndikojnë në paisjet dhe sigurinë e cilësisë së ushqimit për kafshë. Prishjet dhe pluhuri duhet të mbikqyren në atë mënyrë për të parandalohet vershimi nga dëmtuesit.

8. Dritaret dhe hapjet tjera duhet, kur është e nevojshme, të vendosen rrjeta të padepërtueshme kundër dëmtuesve. Dyert duhet të mbyllen mire dhe të jenë të padepërtueshme kundër dëmtuesve kur të mbyllen.

9. Kur është e nevojshme, tavanet dhe paisjet e ndyshme të vjerrura duhet të dizajnohen, ndërtohen dhe mbarohen, për të parandaluar akumulimin e papastërtisë dhe për të zvogëluar kondensimin, rritjen e mykut të padëshirueshëm dhe përhapjen e grimcave që mund të afektojnë sigurinë dhe cilësinë e ushqimit për kafshë.

10. Ndërmarjet që kryejnë një ose më shumë aktivitetet të ndryshme për të vendosur produktet në treg për përdorim në ushqim të kafshëve, i nënshtrohen miratimit në përputhje me nenin 12te kësaj Rregulloreje:

10.1 përpunimi i vajit të papërpunuar bimor përveç atyre që janë në kuadër të Rregullores;

10.2 prodhimi oleokimik i acideve yndyrore;

10.3 prodhimi i bionaftës;

10.4 përzierja e yndyrave.

### III. PERSONELI

Bizneset e ushqimit për kafshë duhet të kenë staf të mjaftueshëm të aftësuar dhe kualifikuar të nevojshme për prodhimin e produkteve në fjalë. Një skemë organizative që përcakton kualifikimet (p.sh. diploma, përvoja profesionale) dhe përgjegjësitë e stafit mbikëqyrës ku përshkrimet vihen në dispozicion autoriteteve kompetente përgjegjëse për inspektim. I gjithë stafi duhet të informohet në mënyrë të qartë me shkrim për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e tyre, sidomos kur bëhet ndonjë ndryshim, në mënyrë që të arrihet cilësia e dëshiruar e produktit.

### IV. PRODHIMI

1. Duhet të përcaktohet një person i kualifikuar dhe përgjegjës për prodhimin.

2. Operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë duhet të sigurojnë që fazat e ndryshme të prodhimit të kryhen sipas procedurave të paracaktuara dhe udhëzimeve me shkrim që synojnë përcaktimin, kontrollin dhe zotërimin e pikave kritike të procesit të prodhimit.

3. Duhet të ndërmerren masa teknike ose organizative për të shmangur ose minimizuar, sipas nevojës, çdo kontaminim të kryqëzuar dhe gabimeve. Duhet të ketë mjete të mjaftueshme dhe të përshtatshme për kryerjen e kontrolleve gjatë prodhimit.

4. Prania e substancave të padëshirueshme dhe të ndaluar në ushqimin për kafshë dhe ndotësve të tjerë sa i përket shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve duhet të monitorohen dhe duhet të vendosen strategji adekuate të kontrollit për të minimizuar rrezikun.

5. Mbeturinat dhe materialet që nuk janë të përshtatshme si ushqim për kafshë duhet të izoloohen dhe identifikohen. Çdo material i tillë që përmban nivele të rrezikshme të barnave veterinare, ndotësve ose rreziqeve të tjera duhet të asgjësohen në një mënyrë të përshtatshme dhe të mos përdoren si ushqim për kafshë.

6. Operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë duhet të marrin masa adekuate për të siguruar gjurmimin efektiv të produkteve.

7. Ndërmarrjet për përzierjen e yndyrnave që vendosin produktet e destinuara në treg për ushqim të kafshëve duhet të mbajnë të gjitha produktet të ndara fizikisht nga produktet e destinuara për qëllime të tjera përveç nëse ato produktet janë në pajtueshmëri:

7.1. me kërkesat e kësaj Rregulloreje ose të Nenit 5 (2) të Rregullores Nr. 11/2011 për higjienën e produkteve ushqimore, dhe

7.2. me Aneksin II të Rregullores 43/2013 që përcakton nivelet maksimale të ndotësve të caktuar në produktet ushqimore dhe substancat e padëshiruara në ushqimet e kafshëve.

8. Etiketimi i produkteve duhet të tregojë qartë nëse ato janë të destinuara për ushqim të kafshëve ose për qëllime të tjera. Nëse një numër identifikues i caktuar i një produkti është deklaruar si jo i destinuar për përdorim të ushqimit për kafshë, kjo deklaratë nuk duhet të ndryshohet më pas nga një operator në një fazë të mëvonshme të zinxhirit.

9. Etiketimi i materialeve të ushqimit për kafshë sipas sipas legjislacionit specifik për vendosjen në treg dhe përdorimin e ushqimit për kafshë duhet të përdorë, kur është e mundur, emërtimet e përcaktuara në legjislacioni specifik në katalogun e materialeve ushqyese.

## V. KONTROLLI I CILËSISË

1. Kur është e përshtatshme, duhet të përcaktohet një person i kualifikuar përgjegjës për kontrollin e cilësisë.

2. Bizneset e ushqimit për kafshë duhet, si pjesë e një sistemi të kontrollit të cilësisë, të kenë qasje në një laborator me staf dhe pajisje adekuate.

3. Plani i kontrollit të cilësisë duhet të hartohet me shkrim dhe të zbatohet, duke përfshirë në veçanti, kontrollet mbi pikat kritike të procesit të prodhimit, procedurat e marrjes së mostrave dhe frekuencat, metodat e analizës dhe frekuencën e tyre, pajtueshmërinë me specifikimet - dhe destinacionin në rastin e mospërputhjes - nga materialet e përpunuara tek produktet finale.

4. Dokumentacioni që ka të bëjë me lëndët e para të përdorura në produktet finale duhet të mbahet nga prodhuesi për të siguruar gjurmueshmërinë. Dokumentacioni i tillë duhet të jetë në dispozicion autoriteteve kompetente për një periudhë të përshtatshme të përdorimit për produktet që janë të vendosur në treg. Përveç kësaj, mostrat e ingridiencve dhe të çdo grumbulli të produkteve të prodhuara dhe të vendosura në treg ose të secilës pjesë specifike të prodhimit (në rastin e prodhimit të vazhdueshëm) duhet të merren në sasi të mjaftueshme duke përdorur një procedurë të paracaktuar nga prodhuesi dhe të ruhen, në mënyrë që të sigurohet gjurmueshmëria (në mënyrë të rregullt në rastin e prodhimit vetëm për nevojat e prodhuesit). Mostra duhet të vulosen dhe etiketohen për identifikim të lehtë; Ato duhet të ruhen në kushte të cilat pengojnë ndonjë ndryshim në përbërjen e mostrës ose ndonjë falsifikim. Ato duhet të mbahen në dispozicion autoriteteve kompetente për një periudhë të përshtatshme të përdorimit për të cilin ushqimi për kafshë është vendosur në treg. Në rastin e ushqimit për kafshë për kafshët që nuk mbahen për prodhimin e ushqimit, prodhuesi i ushqimeve për kafshë duhet të mbajë vetëm mostrat e produktit të përfunduar.

## **VI. MONITORIMI I DIOKSINIT PËR VAJRAT, YNDYRNAT DHE PRODUKTET TË DERIVUARA**

1. Operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë që vendosin në treg, yndyrna, vajra ose produkte që rrjedhin prej tyre të destinuara për përdorim në ushqim për kafshë, përfshirë ushqimin e përbërë të kafshëve, duhet të analizojnë ato produkte në laboratorët e akredituar për shumën e dioksinave dhe PCB-ve (bifenilet të poliklorinuara) në përputhje me legjislacion specifik që percakton metodat e marrjes së mostrave dhe analizave për kontrollin zyrtar të ushqimit për kafshë.

2. Për të plotësuar sistemin HACCP të operatorit të biznesit me ushqim për kafshë, analizat e përmendura në pikën 1 duhet të kryhen se paku sips frekuencave të mëposhtme (nëse nuk specifikohen më tej, një grumbull i produkteve që duhet të analizohen nuk duhet të kalojë 1 000 ton):

2.1 Operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë që procesojnë yndyrna dhe vajra bimore të papërpunuara:

2.1.1 100% e grumbujve të produkteve të nxjerra nga vajra dhe yndyrna meorigjinë bimore, me përjashtim të atyre që vijnë:

2.1.1.1 glicerinë,

2.1.1.2 lecitin,

2.1.1.3 goma, (material ngjites i dale nga bimët),

2.1.1.4 produktet të përmendur në 2.1.2.;

2.1.2 vajra acide nga rafinimi kimik, materiali nga i cili prodhohet sapuni, pajisjet ndihmëse të filtrave të përdorura, argjila zbardhuese e përdorur dhe grumbujt hyrëse të vajit të kokosit të papërpunuar duhet të analizohen dhe dokumentohen si pjesë e sistemit HACCP.

2.2 Operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë që prodhojnë yndyrë të kafshëve duke përfshirë përpunuesit e yndyrës së kafshëve:

2.2.1 një analizë reprezentative për 5 000 ton me një minimum prej një analize reprezentative në vit për yndyrën e kafshëve dhe produktet e nxjerra prej saj që i përkasin materialit të kategorisë 3, siç është përcaktohet me legjislacionin specifik që përcakton rregullat shëndetësore në lidhje me nënproduktet e kafshëve dhe produktet e prejardhura që nuk janë të destinuara për konsum njerëzorose nga një objekt i miratuar në përputhje me Nenin 5 të Rregullores (12/2011) përcakton rregullat specifike mbi higjienën e ushqimit me origjinë shtazore.

2.3 Operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë që prodhojnë vaj peshku:

2.3.1 100% e grumbujve të vajit të peshkut nëse është prodhuar nga:

2.3.1.1 produkte që rrjedhin nga vaji i peshkut përveç vajit të rafinuar të peshkut;

2.3.1.2 vendi ku rriten peshqit për qëllime tregtarepa histori të monitorimit, me origjinë të paspecifikuar ose nga Deti Baltik;

2.3.1.3 nënproduktet e peshkut nga objektet që prodhojnë peshq për konsum njerëzor që nuk janë miratuar nga BE;

2.3.1.4 speciet të kaltërtamerluc ose haring e madhe;

2.3.2 100% e grumbujve dalëse të produkteve të nxjerrura nga vaji i peshkut përveç vajit të peshkut të rafinuar;

2.3.3 një analizë representative për 2 000 ton në lidhje me vajin e peshkut që nuk referohet në 2.3.1.;

2.3.4 vaj peshku i dekontaminuar nga një trajtim i miratuar zyrtarisht siç përcaktohet nga legjislacioni specifik për vendosjen në treg dhe përdorimin e ushqimit dhe në legjislacionin specifik që përcakton kriteret e pranueshmërisë për proceset e detoksifikimit të aplikuara për produktet e dedikuara për ushqimin për kafshëdo të analizohen dhe dokumentohen si pjesë e sistemit HACCP.

#### 2.4 Industria oleokimike e cila plasohet ushqimin për kafshë në treg:

2.4.1 100% e grumbujve hyrëse të yndyrave të kafshëve që nuk mbulohen nga pika 2.2. ose 2.8., vaj peshku që nuk mbulohet nga pika 2.3. ose 2.8., vajrat dhe yndrat e përfuara nga operatorët e biznesit të ushqimit që përfshihen në fushën e veprimit të Rregullores Nr. 11/2011 për higjienën e produkteve ushqimore dhe të yndyrave dhe vajrave të përziera;

2.4.2 100% e grumbujve të produkteve të nxjerra nga vajrat dhe yndyrat e vendosura si ushqim për kafshë në treg, përveç si vijon:

2.4.2.1 glicerinë,

2.4.2.2 acidet yndyrore të pastra të distiluara nga ndarja,

2.4.2.3 produktet të referuara në 2.4.3.;

2.4.3 acidet yndyrore nga ndarja të papërpunuara, acidet yndyrore esterifikuara me glicerinë, mono dhe digliceridet e acideve yndyrore, kripërat e acideve yndyrore dhe grumbujt hyrëse të vajit të papërpunuar kokosit do të analizohen dhe dokumentohen si pjesë e sistemit të HACCP.

#### 2.5 Industria e bionaftës që vendos ushqimin për kafshë në treg:

2.5.1 100% e grumbujve hyrëse të yndyrave të kafshëve që nuk mbulohen nga pika 2.2. ose 2.8., vaj peshku që nuk mbulohet nga pika 2.3. ose 2.8., vajrat dhe yndrat e përfuara nga operatorët e biznesit të ushqimit që përfshihen në fushën e veprimit të Rregullores Nr. 11/2011 mbi higjienën e produkteve ushqimore dhe të yndyrave dhe vajrave të përziera;

2.5.2 100% e grumbujve të produkteve të nxjerra nga vajrat dhe yndyrat e vendosura si ushqim për kafshë në treg, përveç si vijon:

2.5.2.1 glicerinë,

2.5.2.2 lecitin,

2.5.2.3 goma, (material ngjites i dale nga bimët) (Gomë celuloze),

2.5.2.4 produktet të përmendura në 2.5.3.;

2.5.3 Vajrat acid nga rafinimi kimik, materiali nga i cili prodhohet sapuni dhe vaji i kokosit i papërpunuar duhet të analizohen dhe dokumentohen si pjesë e sistemit HACCP.

## 2.6 Objektet e përzierjes së yndyrës:

2.6.1 100% e grumbujve hyrëse të vajit të papërpunuar të kokosit, yndyrna shtazore që nuk mbulohen nga pika 2.2. ose 2.8., vaj peshku që nuk mbulohet nga pika 2.3. ose 2.8., vajrat dhe yndrat e përfituara nga operatorët e biznesit të ushqimit që përfshihen në fushën e veprimit të Rregullores Nr. 11/2011 i higjienës e produkteve ushqimore dhe yndyrmat dhe vajrat e përziera dhe produktet e nxjerra nga vajrat dhe yndyrat, me përjashtim të atyre që vijnë:

2.6.1.1 glicerinë

2.6.1.2 lecitin,

2.6.1.3 goma, (material ngjites i dale nga bimët) (Gomë celuloze),

2.6.1.4 produktet e përmendura në 2.6.2.;

2.6.2 vajrat acid nga rafinimi kimik, acide yndyrore nga ndarja të papërpunuara, acidet yndyrore nga ndarja të pastra të distiluara dhe materiali nga i cili prodhohet sapunit duhet të analizohen dhe dokumentohen si pjesë e sistemit HACCP;ose

2.6.3 100% e grumbullit të yndyrave të përziera dhe vajrave të destinuara për ushqim të kafshëve. Operatori i biznesit të ushqimit për kafshëduhet të deklarojë tek autoriteti kompetent se cilën alternativë ai e zgjedhë.

2.7 Prodhuesit e ushqimit të përbërë të kafshëve për kafshët që prodhojnë ushqime përveç nga ato të përfshira në pikën 2.6.:

2.7.1 100% e grumbujve hyrëse të vajit të kokosit të papërpunuar, yndyrna shtazore që nuk mbulohen nga pika 2.2. ose 2.8., vaj peshku që nuk mbulohet nga pika 2.3. ose 2.8., vajrat dhe yndrat e mbuluara nga operatorët e biznesit të ushqimit që përfshihen në fushën e veprimit të Rregullores Nr. 11/2011 mbi higjienën e produkteve ushqimore, yndyrnat dhe vajrat e përziera dhe produktet e nxjerra nga vajrat dhe yndyrat, me përjashtim të atyre që vijnë:

2.7.1.1 glicerinë,

2.7.1.2 lecitin,

2.7.1.3 goma, (material ngjites i dale nga bimët) (Gomë celuloze),

2.7.1.4 produktet e referuara në 2.7.2.;

2.7.2 vajra acide nga rafinimi kimik, acide yndyrorenga ndarja të papërpunuara nga ndarja, acidet yndyrorenga ndarja të pastra të distiluara; mjetet e filtrimit, argjilazbardhuese dhe materiali nga i cili prodhohet sapunit do të analizohen dhe dokumentohen si pjesë e sistemit HACCP;

2.7.3 1% të grumbujve që i përket prodhimit të ushqimit të kafshë që përmbanë produkte të përmendura në 2.7.1. dhe 2.7.2.

2.8 Importuesit që vendosin në tregushqimin për kafshë si në vijim:

2.8.1 100% të grumbujve të importuar të vajit të kokosit të papërpunuar, yndyrave shtazore, vajrave të peshkut, vajrave dhe yndyrave të përfituara nga operatorët e biznesit me ushqim, yndyrnat dhe vajrat e përziera, tokoferolet e nxjerrur nga vaji bimor dhe tokoferol acetat i bërë prej tyre dhe produktet e nxjerra nga vajrat dhe yndyrat, përveç atyre në vijim:

2.8.1.1 glicerinë,

2.8.1.2 lecitin,

2.8.1.3 goma, (Gomë celuloze),

2.8.1.4 produktet e përmendura në 2.8.2;

2.8.2 vajrat acidik nga rafinimi kimik, acide yndyrore të papërpunuara nga ndarja, acidet yndyrore të pastra të distiluara nga ndarja dhe materialet nga i cili prodhohet sapuni duhet të analizohen dhe dokumentohen si pjesë e sistemit HACCP.

3. Nëse mund të demonstrohet se një ngarkesë homogjene është më e madhe se madhësia maksimale e grumbullit sipas pikës 2 dhe se është mostruar në mënyrë të reprezentative, atëherë rezultatet e analizës së mostrës së marrë dhe të vulosur në mënyrë të duhur do të konsiderohen të pranueshme.

4. Kur një operator biznesi me ushqimin për kafshë ka dëshmi në formë dokumenti që një grumbull i produktit ose të gjithë përbërësit e një grumbulli të një produkti të përmendur në pikën 2 që hyjnë në objektin e tij janë analizuar në një fazë më të hershme të prodhimit, përpunimit ose shpërndarjes, operatori do të lirohet nga detyrimi për të analizuar këtë grumbull.

5. Çdo grumbull i produkteve të analizuar në përputhje me pikën 2 duhet të shoqërohet me dëshmi në formë dokumenti që këto produkte, ose të gjithë përbërësit e saj, janë analizuar ose janë dorëzuar për analizë në një laborator të akredituar të referuar në pikën 1, me përjashtim të grumbujve të produkteve të referuara në pikën 2.1.2., 2.2.1., 2.3.3., 2.3.4., 2.4.3., 2.5.3., 2.6.2., 2.7.2. dhe 2.8.2. Prova e analizës duhet në mënyrë të qartë të lidhë shpërndarjen me grumbullin ose grumbujt e testuara. Kjo lidhje duhet të përshkruhet në dokumentacionin e sistemit të gjurmimit në fuqi në hapsirat e furnizuesit. Në veçanti, kur dërgesa është marrë nga më shumë se një grumbull ose përbërës, prova dokumentuese që do të sigurohet do të jetë një provë për secilën nga komponentët e dërgesës. Në rastin kur testimi kryhet në produktin në largim, prova për të cilën produkti është analizuar do të jetë raporti analitik. Çdo dërgesë e produkteve të referuara në pikën 2.2.1. ose 2.3.3. duhet të shoqërohet me dëshmi se këto produkte janë në përputhje me kërkesat e pikës 2.2.1. ose 2.3.3. Nëse kërkohet, prova e analizës që përfshin grumbullin ose grumbujt e dorëzuara duhet t'i dërgohet marrësit kur operatori merr analizën nga laboratorët e autorizuar.

6. Nëse të gjitha grumbujt hyrës të produkteve të referuara në pikën 2.7.1. që hyjnë në procesin e prodhimit janë analizuar në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe nëse mund të sigurohet që procesi i prodhimit, trajtimi dhe ruajtja nuk e rrisin kontaminimin me dioksin, operatori i biznesit të ushqimit për kafshë do të lirohet nga detyrimi për të analizuar produktin në largim dhe në vend të kësajdo të analizojë atë sipas sistemit HACCP.

7. Kur një operator biznesi me ushqim për kafshë kërkon një laborator për të kryer një analizë, siç referohet në pikën 1, ai udhëzon laboratorin që të komunikojë rezultatet e kësaj analize tek autoriteti kompetent në rast se kufijtë dioksinavetë përcaktuara në pikat 1 dhe 2 nëPjesën V të Aneksit II të RREGULLORES (GRK) Nr. 43/2013 e cila përcakton nivelin maksimal të kontaminantve të caktuar në ushqim dhe substancave të padëshiruara në ushqimet e kafshëve janë tejkaluar.

Dëshmitë duhet të sigurohen që laboratori të kryejë analizat në përputhje me legjislacion specifik që përcakton metodat e marrjes së mostrave dhe analizave për kontrollin zyrtar të ushqimit për kafshë.

## VI. RUAJTJA DHE TRANSPORTI

1. Ushqimet e përpunuara të kafshëve duhet të ndahen nga materialet ushqimore të papërpunuara të kafshëve dhe aditivët, me qëllim që të shmangen kontaminimet e kryqëzuara të ushqimeve të përpunuara të kafshëve; duhet të përdoren materialet e duhura paketuese.
2. Ushqimi për kafshë duhet të ruhet dhe të transportohet në kontejnerë të përshtatshëm. Ato do të ruhen në vende të projektuara, të përshtatura dhe të mirëmbajtura për të siguruar kushte të mira të ruajtjes, në të cilat kanë qasje vetëm personat e autorizuar nga operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë.
3. Ushqimet për kafshë duhet të ruhen dhe të transportohen në mënyrë që të jenë teidentifikueshme lehte, në mënyrë që të shmangen ngatërrimet ose kontaminimin e kryqëzuar dhe të parandalohet përkeqësimi.
4. Kontejnerët dhe pajisjet e përdorura për transportin, ruajtjen, bartjen, trajtimin dhe matësit e ushqimit për kafshë duhet të mbahen të pastra. Do të futen programe të pastrimit dhe gjurmëte detergjentëve dhe dezinfektuesve do të minimizohen.
5. Çdo dëmtime të jashtme duhet të minimizohen dhe të mbahet nën kontroll për të zvogëluar pushtimin nga dëmtuesit.
6. Kur është e përshtatshme, temperaturat duhet të mbahen sa më të ulëta për të shmangur kondensimin dhe dëmtimet.
7. Kontejnerët që shërbejnë për ruajtjen ose transporttë yndyrave të përzier, vajra me origjinë bimore ose produkte të nxjerra nga ato të destinuara për përdorim në ushqim për kafshë nuk duhet të përdoren për transportin ose ruajtjen e produkteve të ndryshme nga këto, përveç nëse produktet përputhen me kërkesat e:

7.1 kësaj Rregullorejeose apo nenit 5(2) të Rregullores 11/2011 mbi higjienën e produkteve ushqimore dhe,

7.2 Aneksit II të Rregullores (GRK) Nr. 43/2013i cili përcakton nivelet maksimale të kontaminatve të caktuar në ushqimet dhe substancat e padëshirueshme në ushqimet e kafshëve.

Ato do të mbahen të ndara nga çdo ngarkesë tjetër ku ekziston rreziku i kontaminimit.

Kur përdorimi i veçantë nuk është i mundur, kontejnerët duhet të pastrohen në mënyrë efektive që të largojnë çdo gjurmë e ndonjë produkti nëse këto kontejnerë janë përdorur më parë për produktet që nuk plotësojnë kërkesat e:

7.3 kjo Rregullore ose e nenit 5 (2) të Rregullores Nr. 11/2011 për higjienën e produkteve ushqimore, dhe

7.4 Aneksit II të Rregullores (GRK) Nr. 43/2013 i cili përcakton nivelet maksimale të kontaminatve të caktuar në ushqimet dhe substancat e padëshirueshme në ushqimet e kafshëve.

Yndyrnat e kafshëve të kategorisë 3, siç është përcaktohet me legjislacionin specifik që përcakton rregullat shëndetësore në lidhje me nënproduktet e kafshëve dhe produktet e prejardhura që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor, të destinuara për përdorim në ushqim për kafshë duhet të ruhen dhe të transportohen në përputhje me atë Rregullore.

## VII. MBAJTJA E REGJISTRAVE

1. Të gjithë operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë, duke përfshirë ata që veprojnë të vetëm si tregtar pa mbajtjen e produktit në hapësirat e tyre, duhet të mbajnë në regjistër të dhëna relevante, detajet mbi blerjen, prodhimin dhe shitjet për gjurmim efektiv nga marrja deri në dorëzim, duke përfshirë eksportin deri në destinacion final.
2. Operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë, me përjashtim të atyre që veprojnë vetëm si tregtar pa mbajtjen e produktit në hapësirat e tyre, duhet të mbajnë në regjistër:

2.1 Dokumentacioni që ka të bëjë me procesin e prodhimit dhe kontrollit.

Bizneset e ushqimit për kafshë duhet të kenë një sistem të dokumentacionit të dizajnuar për të përcaktuar dhe siguruar zotërimin e pikave kritike në procesin e prodhimit dhe për të krijuar dhe zbatuar një plan të kontrollit të cilësisë. Ata duhet të mbajnë rezultatet e kontrolleve relevante. Ky grumbull i dokumenteve duhet të mbahet në mënyrë që të jetë e mundur të gjurmohet historia e prodhimit të çdo grumbulli të produkteve të vendosura në qarkullim dhe të vendoset përgjegjësia, nëse paraqiten ankesat.

2.2 Dokumentacion në lidhje me gjurmueshmërinë, në veçanti:

2.2.1 për aditivët e ushqimit për kafshë:

2.2.1.1 natyrën dhe sasinë e aditivëve të prodhuar, datat përkatëse e prodhimit dhe, kur është e mundur, numrin e grumbullit ose të pjesës specifike të prodhimit, në rast të prodhimit të vazhdueshëm,

2.2.1.2 emrin dhe adresën e ndërmarrjes ku janë dërguar aditivët, natyrën dhe sasinë e aditivëve të dërguar dhe, sipas rastit, numrin e grumbullit ose të pjesës specifike të prodhimit, në rast të prodhimit të vazhdueshëm;

2.2.2 përproduktet e mbuluar nga legjislacioni specifik në lidhje me produktet e caktuara të përdorura në ushqimin për kafshë:

2.2.2.1 natyrën dhe sasinë e produkteve të prodhuara, datat përkatëse të prodhimit dhe, kur është e mundur, numrin e grumbullit ose të pjesës specifike të prodhimit, në rast të prodhimit të vazhdueshëm,

2.2.2.2 emrin dhe adresën e ndërmarrjes ose shfrytëzuesve (ndërmarrjet ose fermerët) të cilëve u janë dorëzuar këto produkte, së bashku me detajet e natyrës dhe sasisë së produkteve të dërguara dhe, kur është e përshtatshme, numrin e grumbullit ose të pjesës specifike të prodhimit, në rast të prodhimit të vazhdueshëm;

2.2.3 për parapërzierjet:

2.2.3.1 emrin dhe adresën e prodhuesit ose furnizuesit e aditivëve, natyrën dhe sasinë e aditivëve të përdorur dhe, kur është e përshtatshme, numrin e grumbullit ose të pjesës specifike të prodhimit, në rast të prodhimit të vazhdueshëm,

2.2.3.2 datën e prodhimit të parapërzierjes dhe numrin e grumbullit kur është e përshtatshme,

2.2.3.3 emrin dhe adresën e ndërmarrjes në të cilin është dërguar parapërzierja, datën e dërgimit, natyrën dhe sasinë e parapërzierjes së dorëzuar dhe numrin e grumbullit kur është e përshtatshme.

2.2.4 për ushqimin e përbërë të kafshëve/ materialet e ushqimit të kafshëve:

2.2.4.1 emrin dhe adresën e prodhuesve ose furnizuesve të aditivëve/ parapërzirjeve, apo dërguesve natyrën dhe sasinë e parapërzierave të përdorura, me numrin e serisë kur është e përshtatshme,

2.2.4.2 emrin dhe adresën e furnizuesve të materialeve të ushqimit të kafshëve dhe ushqimeve plotësuese të kafshëve dhe datën e dërgesës,

2.2.4.3 llojin, sasinë dhe formulimin e ushqimit të përbërë të kafshëve,

2.2.4.4 natyrën dhe sasinë e materialeve të ushqimit për kafshë ose të ushqimeve përbërë për kafshë, të përgatitura bashkë me datën e prodhimit dhe emrin dhe adresën e blerësit (p.sh. fermerët, operatorët e tjerë të biznesit të ushqimit për kafshë).

### **VIII. ANKESAT DHE TERHEQJA I PRODUKTEVE**

1. Operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë duhet të zbatojnë një sistem për regjistrimin dhe përpunimin e ankesave.
2. Ata do të vendosin, kur kjo të jetë e nevojshme, një sistem për tërheqjen e menjëhershme të produkteve nga rrjeti ishpërndarjes. Ata do të përcaktojnë me anë të procedurave të shkruara destinacionin e çdo produkti të rikthyer, dhe para se produktet e tilla të vendosen mbrapa në qarkullim, ato duhet t'i nënshtrohen një rivlerësimi të kontrollit të cilësisë.

**SHTOJCA III**  
**PRAKTIKAT E MIRA TË USHQYERIT TË KAFSHËVE**  
**I. PASTRIMI SHPËRNDARJES**

Kullotja në tokat bujqësore duhet të menaxhohet në atë mënyrë që të minimizoj kontaminimin e ushqimeve me origjinë shtazore nga hazardet fizike, biologjike ose kimike.

Kur është e mundëshmedhe e përshtatshme, duhet të respektohet një periudhë e mjaftueshme e pushimit, para se të lejohen bagëtitë të kullosin në kullota, bimë dhe mbetje bimore midis kullosës në menyre rotative për të minimizuar kontaminimin ekryqëzuar biologjik nga plehu, kur ekziston një problem potencial i mundshëm dhe për të siguruar që periudhat e pushimit të zbatohet pas aplikimeve kimike bujqësore që mbetennën vëzhgim.

**II. KËRKESAT PËR STALLAT DHE PAJISJET PËR TË USHQYERIT**

